

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikacryl® Universal Pro

IZOLUES AKRILIK UNIVERSAL

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikacryl® Universal Pro është izolues akrilik universal me 1 përbërës, i përshtatshëm për mbushjen e plasaritjeve dhe fugave në mjedise të brendshme dhe të jashtme (me strehë). Është një izolues plastik-elastik me kosto efikase, posaçërisht i përshtatshëm për fugat jolëvizëse (statike).

PËRDORIMET

- Izolim i fugave me lëvizje të ulët midis materialeve të ndryshme të ndërtimit (dru, beton, tulla, etj.)
- Mbushje plasaritjesh në mure dhe tavane
- Izolim i fugave të lidhjes midis dritareve, mureve, dyerve, etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Mund të lyhet
- Mund të përdoret mbi të gjitha sipërfaqet poroze si tulla, betoni, druri, etj.
- Aplikim dhe pastrim shumë i lehtë
- I papërshkueshëm nga uji pas tharjes
- Pa erë
- Vetë të mira aplikimi
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme
- Rezistencë e mirë ndaj UV
- Rezistencë ndaj shiut

MIRATIME / STANDARDE

EN-15651-1: F-EXT-INT, Class 7.5P

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	dispersion akrilik me 1 përbërës
Ambalazhi	tubetë 310 ml, 24 copë/ kuti
Ngjyra	E bardhë
Jetëgjatësia	15 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në kushtë të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica, në temperatura midis +5 °C dhe +25 °C.
Dendësia	~ 1,62 ± 0,03 kg/lit (ASTM D 792)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	40-70
Zgjatimi deri në thyerje	≥100 % (ASTM D 412)
Aftësia për lëvizje	± 7,5% (ISO 11600)
Temperatura e funksionimit	-10 °C deri në +80 °C

Projektimi i fugës

Gjerësia e fugës duhet të projektohet për t' u përshtatur me lëvizjen e kërkuar fugës dhe aftësisë së izoluesit për lëvizje. Gjerësia e fugës duhet të jetë ≥ 5 mm dhe ≤ 25 mm. Duhet të ruhet raporti 2:1 i gjerësisë me thellësinë (për përjashtimet shih tabelën më poshtë). Për fuga më të gjera, ju lutemi kontaktoni departamentin e shërbimit teknik.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi

Gjatësi fugë [m] = 310 ml / (gjerësi fugë [mm] x thellësi fugë [mm])
Litra / Metër linear fugë = (gjerësi fugë [mm] x thellësi fugë [mm]) / 1000 [m x mm² / l]

Gjatësi fugë [m] për 310 ml	Gjerësi fugë [mm]	Thellësi fugë [mm]
20,7	5	3
6,2	10	5
2,6	15	8
1,6	20	10
1	25	12

Fugat trekëndore (aty ku anët e fugës takohen në kënd të drejtë) duhet të kenë anë ≥ 7 mm.

Temperatura e mjedisit

+5 °C deri në +40 °C, min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës

Ritmi i maturimit

2 mm/ditë (në +23 °C dhe 50% lagështi relative)

Koha e tharjes së sipërfaqes

50 ± 20 min

(ASTM C 679)

Në +23 °C dhe 50% lagështi relative

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Fugat duhet të jenë të pastra dhe pa pluhur, graso dhe ndryshk. Mbi sipërfaqet poroze si betoni, guri, çimentoja dhe suvaja mund të aplikohet prajmer (përzierje e një pjese izoluesi akrilik dhe 4-5 pjesësh uji). Mbi plastikat dhe bojërat, duhet të kryhen testime ndërkapjeje përpara aplikimit. Hekuri dhe çeliku duhet të mbrohen me prajmer kundër korrodimit.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sikacryl® Universal Pro është gati për përdorim. Pas përgatitjes së nevojshme të nënshtresës, vendosni tubetën brenda pistoletës dhe nxirrni Sikacryl® Universal Pro brenda fugës duke u siguruar se është në kontakt të plotë me të dyja anët e fugës pa ajër të bllokuar. Izoluesi Sikacryl® Universal Pro duhet të ngjeshet mirë në anët e fugës për të siguruar një ndërkapje të plotë. Rekomandohet përdorimi i shiritave maskues aty ku kërkohen vija të sakta dhe vija të drejta fugash. Hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores. Mos përdorni produkte me përmbajtje tretësi. Menjëherë pas aplikimit lëmoni izoluesin me një vegël të lagur.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nuk duhet të përdoret për izolimin e fugave me ekspozim të përhershëm ndaj presionit të ujit, ujit të ndenjtur ose të zhytura në ujë.
- Nuk duhet të aplikohet në rast rreziku nga shiu apo ngrice.
- Produkti nuk është elastik; ndaj dhe nuk duhet të përdoret për fugat e zgjerimit.
- Mund të lyhet me bojëra që kanë elasticitet të mjaftueshëm. Megjithatë, duhet të testohet më parë kompatibiliteti i bojërave duke kryer testime paraprake (p.sh. sipas dokumentave teknike ISO: Mundësia për lyerje dhe kompatibiliteti i izoluesve).
- Mund të ndodhin ndryshime në ngjyrë për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (sidomos në ngjyrën e bardhë). Megjithatë, ndryshimi në ngjyrë është plotësisht i natyrës estetike dhe nuk ndikon negativisht në performancën teknike apo qëndrueshmërinë e produktit.
- Nuk rekomandohet aplikimi në temperatura të larta (lëvizje gjatë tharjes).
- Mos përdorni Sikacryl® Universal Pro si izolues xhamash, në fugat e dysHEMEVE, në fugat e pajisjeve hidrosanitare, mbi mermer, gurin natyror dhe inxhinierinë civile.
- Mos përdorni Sikacryl® Universal Pro mbi nënshtresa bituminoze, gomë natyrore, gomë EPDM ose mbi çdo material ndërtimi nga ku mund të rrjedhin plastifikues ose tretës të cilët mund të sulmojnë izoluesin.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikacryl® Universal Pro

Shtator 2019, Botimi 03.01

02051404000000094

SikacrylUniversalPro-sq-AL-(09-2019)-3-1.pdf